

Dr. Bashkim Aliu & Mr. Rehan Neziri

# **EKSTREMIZMI NË EMËR TË ISLAMIT**

Cyrih, 2018

**Boton:** Unioni i Bashkësive Islame Shqiptare në Zvicër  
(UBISHZ – [www.daigs.ch](http://www.daigs.ch))

**Redaktura:** Hfz. Mehas Alija

**Lektura:** Mr. Elez Ismaili

**Ballina:** Xhemil Bajrami

**Shtypi:** Focus Print - Shkup

**Tirazhi:** 1000 copë

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

## **Përmbajtja:**

Parathënie .....	V
Hyrje .....	IX

### **Kapitulli I – Ekstremizmi në fenë islame**

EKSTREMIZMI NË FE, SHKAQET DHE EVITMI .....	1
Përkuftizimi .....	2
<i>Backgroundi</i> fetar i refuzimit të ekstremizmit: .....	5
A. Cilësimi i ummetit .....	5
B. Ndalimi i tepimit .....	7
C. Qëndrimi ndaj jomuslimanëve .....	15
Shkaqet e ekstremizmit fetar: .....	25
1. Plan-programet mësimore joadekuate .....	25
2. Keqkuptimi i çështjeve fetare, fanatizmi në mendim .....	26
3. Mosmarrja parasysh e dallimeve të njerëzve .....	39
4. Keqkuptimi i devotshmërisë .....	40
5. Mosdallimi i dispozitave lidhur me luftën dhe paqen .....	43
6. Keqkuptimi i urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja ..	44
7. Përqendrimi i shtresave popullore në çështjet dytësore .....	48
8. Kapja e institucioneve fetare .....	48
9. Traditat lokale dhe rrethanat sociale .....	49
10. Mungesa e kuadrit adekuat .....	50
Evitimi i ekstremizmit në fe .....	51
Literatura .....	62

### **Kapitulli II – Grupet ekstremiste islame gjatë historisë**

KUSH JANË RADIKALËT DHE EKSTREMISTËT MUSLIMANË? .....	67
Kush janë <i>havarixhët</i> ? .....	80
Kush janë <i>selefistët</i> ? .....	83
Karakteristikat e grupeve ekstremiste .....	88
Profili ideologjik i një ekstremisti musliman .....	90
Literatura .....	98

### **Kapitulli III – Radikalizimi i të rinjve muslimanë në Perëndim**

#### **RADIKALIZIMI I TË RINJVE MUSLIMANË NË PERËNDIM**

Përkufizimi i nocionit “radikal” .....	109
Shkaqet dhe faktorët e mundshëm të radikalizimit .....	115
Modalitetet e procesit të radikalizimit .....	122
Sfidat dhe detyrat e përbashkëta gjithëshoqërore.....	134
Deradikalizimi.....	137
Roli i familjes dhe i rrethit social.....	139
Roli i shkollës .....	144
Roli i komunitetit musliman .....	145
Roli i politikës dhe i mediave .....	151
Përmbyllje.....	159
Literatura.....	160
<b>Shtojca 1 – Deklaratë e muslimanëve shqiptarë në Zvicër .....</b>	<b>163</b>
<b>Shtojca 2 – Qarkore xhamive shqiptare rreth ekstremizmit.....</b>	<b>167</b>

## Parathënie

All-llahut i takon falënderimi më i parë, deri sa të kënaqet me ne; Atij i takojnë lutjet tona, deri sa t'i pranojë ato dhe i takon çdo gjë që ekziston në tokë dhe në qiej. Përshëndetjet dhe nderimet tona ia dedikojmë Pejgamberit tonë të dashur, Muhammedit alejhis-selam, ndërsa lutemi vazhdimisht që Zoti ynë të bekojë dhe të nderojë, lartë e më lartë, familjarët e tij, si dhe shokët besnikë, as'habët.

Islami është fe e natyrshme dhe e pastër, fe e mendjes së arsyeshme dhe e logjikës së drejtë. Kjo fe, e shpallur nga All-llahu i Gjithëfuqishëm, e kumtuar nga Pejgamberi i fundit, Muhammedi alejhis-selam, e përcjellë me besnikëri nga shokët e tij, si dhe e komentuar dhe shpjeguar nëpër shekuj nga dijetarët mendjendritur, në dorën e saj bart shkaqet e ekzistencës së saj dhe shkaqet e lumturisë së njerëzimit.

T'ia veshësh Islamit petkun e jotolerancës, radikalizmit, ekstremizmit apo të terrorizmit, do të thotë që atij t'i mohohet e drejta dhe e vërteta se ai është kundër çdo dhune, se bën thirrje për bashkëjetesë, tolerancë, dialog, mirëkuptim të ndërsjellë ndërmjet vetë muslimanëve dhe të besimeve të tjera.

Në botën bashkëkohore, përveç tendencave për ta larguar njeriun nga feja, ekzistojnë rryma dhe grupe të caktuara që me pikëpamjet e tyre tentojnë të joshin një kategori të rinjsh, që nuk dinë asgjë ose shumë pak nga feja e tyre dhe mashtrohen me ideologjitë e tyre të improvizuara si fe.

Për një vetëdijesim më të mirë dhe për t'iu shmangur shtresimeve dhe drejtimeve të shtrembëruara të muslimanëve shqiptarë këtu në Zvicër, e sidomos të rinjve, fillimisht, Unioni i Imamëve Shqiptarë në Zvicër, mori përsipër të organizojë disa

seminare me të rinjtë e xhemateve shqiptare, ku realizoi tre takime në tri xhami, me ç'rast morën pjesë një numër i konsiderueshëm i të rinjve. Merita të mëdha për organizimin e suksesshëm të këtyre takimeve kanë xhamitë shqiptare, Xhamia e Bardhë në Aarbug, Xhamia Shqiptare në Cyrih si dhe xhamia "Hëna e Re" në Kreuzlingen, kryesitë e të cilave i pritën me shumë nderim të rinjtë e xhamive të tjera, pjesëmarrëse në seminarët tona. Me mirënjohje të lartë theksoj kontributin e madh që dhanë dy teologët e shquar dhe imamët tanë të dalluar, jo vetëm këtu në Zvicër por edhe më gjërë, Dr. Bashkim Aliu dhe Mr. Rejhan Nezirri, të cilët me kumtesat dhe shpjegimet e tyre, në këto tri seminare, bënë që pjesëmarrësit të marrin informacione të hollësishme në lidhje me ekstremizmin në fe dhe dëmet që mund të shkaktojnë te të rinjtë qasjet ideologjike dhe të skajshme fetare. Pas mbarimit me sukses të këtyre seminareve, kryesia e Unionit të Bashkësive Islame Shqiptare në Zvicër (UBISHZ), duke marrë edhe pëlqimin e autorëve, vendosi që kumtesat në fjalë t'i botojë në një libër të veçantë, të cilin ju, tanimë, të dashur lexues, e keni para vetes.

Në këtë libër bëhet një hulumtim, fillimisht, rreth historikut të qasjeve ekstremiste dhe identifikimit të faktorëve të cilët ndikojnë në sjelljet e skajshme të individëve, në rastin tonë të ca grupeve muslimane, e që idenë dhe veprimtarinë e ushtrojnë përmes formave të dhunshme të radikalizmit dhe ekstremizmit. Meqë Islami, në bërthamën e tij, nuk njeh dhe nuk pranon asnjë lloj ekstremizmi, autorët e librit, në të njëjtën kohë, përpiqen që të ofrojnë zgjidhje dhe pikëpamje objektive, reale, të dashur dhe të arsyeshme në lidhje me atë se çfarë mund të ndikojë në zvogëlimin dhe mënjanimin e eskalimit të ekstremizmit në shoqërinë tonë në përgjithësi, e sidomos te të rinjtë shqiptarë muslimanë në veçanti.

Për një veprim human në parandalimin e dukurive devijante të të rinjve tanë, meritë të veçantë kanë imamët dhe kryesitë e xhamive tona, që veprojnë në kuadër të Unionit të Bashkësive Islame Shqiptare në Zvicër (UBISHZ), të cilët me punën dhe

kontributin e tyre janë munduar t'i ruajnë vlerat burimore, tradicionale dhe kulturore të trashëgimisë sonë islame shqiptare, vlera këto që, assesi nuk janë identifikuar me elemente të dhunës, skajshmërisë dhe të ekstremizmit. Nuk ka qenë punë e lehtë të merreshim me dukuri të kësaj natyre, aq më keq kur ato janë të shpifura dhe prekin thellë sedrën e çdo besimtari. Për këtë arsye, imamët dhe kryesitë e xhamive tona meritojnë falënderimet më të përzemërta. Po ashtu, u shprehim mirënjohje edhe anëtarëve të ish-kryesive të Unionit të Imamëve Shqiptarë në Zvicër, me në krye kryetarët Mr. Rehan ef. Neziri dhe Mr. Nehat ef. Ismaili, të cilët, përmes angazhimit të tyre profesional, ofruan alternativën dhe rrugën e mesit për të rinjtë tanë dhe atë duke organizuar seminare dhe programe edukative e informative për vetëdijesimin e tyre nga rreziqet e radikalizmit, ekstremizmit dhe terrorizmit.

Ne mbetemi me shpresë se sektori për veprimtari botuese në kuadër të UBISHZ-së do të vazhdojë edhe më tutje të ofrojë për lexuesit tanë shqiptarë vepra me vlera të veçanta, të cilat do të jenë ndriçuese të vërteta të mendjes dhe rrugës sonë drejtë formimit tonë të mirëfilltë si shoqëri, komunitet shqiptar dhe si bashkësi muslimane në Zvicër.

Hfz. Mehas Alija  
Kryetar i UBISHZ-së





## Hyrje

Në vitet e kaluara, sidomos midis viteve 2014-16, u intensifikua tej mase dukuria e ikjes së shumë të rinjve muslimanë nga vendet evropiane për t'iu bashkëngjitur radhëve të organizatave terroriste në Siri e Irak, të cilat pretendonin se po krijonin shtetin islam, “parajsën e humbur” dhe shumë të dëshiruar. Kështu, për shembull, sipas të dhënave të Shërbimit Informativ Federal (NDB) të Zvicrës, deri më tani janë regjistruar gjithsej 93 raste të këtilla. Ndër këta persona, një duzinë janë gra, kurse më shumë se 20 djem e vajza janë nën moshën dymbëdhjetë vjeçe. Nga këto raste, 78 janë nisur për në Siri dhe Irak, 15 për në Somali, Afganistan dhe Pakistan dhe një person për në Filipine, të gjithë me qëllim të angazhimit në aktivitete xhihadiste. 32 nga këta 93 persona tanimë kanë vdekur (26 raste të konfirmuara). Numri i atyre që janë kthyer sërish në Zvicër sillet te 16, prej të cilëve 13 janë të konfirmuar. Nga këta 93 persona, 31 prej tyre kanë nënshtetësinë zvicerane, ndërsa 19 prej tyre kanë dyshtetësi. Të dhëna të tjera rreth identitetit, moshës, gjinisë, nacionalitetit ose vendbanimit të tyre Shërbimi Informativ nuk vë në dispozicion.\* Mirëpo, nga rastet e mëhershme, ne kemi mundur të kuptojmë se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë me origjinë nga Ballkani, respektivisht i lartë është edhe numri i shqiptarëve. Ajo çka nuk mund të mohohet assesi, është fakti se të gjithë këta janë të rinj që i përkasin fesë islame, qofshin me origjinë familjare islame, qofshin edhe të konvertuar. Pra, janë bijat dhe bijtë tanë muslimanë, që dikush dhe disa rrethana të caktuara i kanë shtyrë ata ta ndërmarrin një hap të kë-

---

\* „Dschihadistisch motivierte Reisebewegungen – Zahlen August 2018“, në [www.vbs.admin.ch](http://www.vbs.admin.ch) (shikuar më 30.08.2018)

tillë. Këto shifra, bashkë me të tjerat nga të gjitha shtetet evropiane, i kanë nxitur edhe debatet rreth radikalizmit, ekstremizmit dhe terrorizmit me sfond islam. Duke u nisur nga këto raste, shumë politikanë, opinionbërës e media, nisën të flasin për “islamin terrorist”, për “islamin fashist”, pa i përdorur thonjëzat. Si rrjedhojë e kësaj, ekstremizmi zuri vend gjithnjë e më shumë në debatet publike të kohëve të fundit, si në ato të nivelit lokal, po ashtu edhe në ato të atij ndërkombëtar. Me këtë rast ky nocion përdorej në kontekste të ndryshme. Ekstremizmi fetar dhe ndikimi i tij në shoqëritë e sotme, është një nga temat më të eksploruara dhe nocionet më frekuentuese në mediumet e shkruara dhe elektronike, si dhe temë debati në qarqe të ndryshme akademike. Për këtë temë është shkruar dhe shkruhet shumë, ngase është shndërruar në temë që e tangon gjithë botën, e jo vetëm disa shoqëri të caktuara. Shtrirja e përdorimit të nocionit “ekstremizëm” në fusha të ndryshme, imponon nevojën e përcaktimit të saktë të fushës, të kontekstit dhe të nivelit të nocionit ekstremizëm, me qëllim që të mos shkaktohet konfuzion në trajtimin e dukurisë në fjalë, si dhe në shkoqitjen e kuptimit, referimit dhe reflektimit të këtij termi dhe implikimeve të kësaj dukurie. Megjithatë, si rezultat i zhvillimeve dramatike në Lindjen e Mesme, ku janë të përqendruar kryesisht muslimanët arabë dhe muslimanët e disa etnive të tjera, ky nocion është shndërruar pothuajse në sinonim për Islamin dhe muslimanët, madje sa herë që përmendet ekstremizmi, nën trysninë e medimeve, aludohet në ngjyrimin fetar islam të këtij fenomeni dhe në praktikën e komunitetit musliman, duke lënë nën hije gjenezën e termit ekstremizëm, si dhe kuptimin dhe shtrirjen e tij tek të gjitha komunitetet.

Një fushë e rëndësishme dhe mjaftë senzitive, si dhe me përmasa botërore e përdorimit të termit “ekstremizëm”, është edhe ajo fetare. Mirëpo, duke marrë parasysh shtrirjen e gjërë të debatit për këtë dukuri brenda fushës në fjalë, përkufizimi i këtij punimi do të bëhet fillimisht në kuadër të Fesë Islame, edhe atë, në kontekstin juridik të Islamit, ngase palë të ndryshme, të cilat thirren në dijet fetare islame, e konstituojnë dome-

nin normativ të Islamit dhe derivatet e këtij domeni në jetën shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, humane, etj., mbi të kuptuarit e tyre personal të teksteve fetare islame dhe leximin restriktiv të dispozitave dhe parimeve bazë të Islamit, konform një metodologjie të caktuar, e cila ka një suficit të theksuar të fleksibilitetit, të elasticitetit, të pluralizmit dhe të tolerancës.

Tema e ekstremizmit në të kuptuarit e dispozitave fetare, si një nga inicuesit më serioz dhe më të fuqishëm të fenomenit të ekstremizmit të disa fetarëve, e që më pas artikullohet si “ekstremizëm në fe”, nuk do të jetë e plotë dhe me rezultate të dëshiruara, nëse trajtohen vetëm shkaqet e një dukurie të tillë, si dhe *backgroundi* fetar i refuzimit të ekstremizmit, duke u thirrur në argumente të burimeve bazike islame, si dhe në konstatime dhe pohime të dijetarëve dhe institucioneve relevante islame, në veçanti drejtuar këshillave, organizatave, instituteve dhe akademive, të cilat janë të përqendruara në decizionet fetare (*fetvatë*) kolektive, si tendencë për të qenë më të pjekur në vlerësime, më kredibil në përfundime dhe më të saktë në analizë, si dhe më të pranueshëm në masë. Kjo problematikë do të ishte më e kompletuar në kuptim të efektit në masë dhe të pranimit në qarqet akademike, si dhe do të paraqiste një referencë të rëndësishme për studiuesit, nëse trajtohet edhe evitimi i kësaj dukurie, duke u thirrur në burimet relevante të së drejtës islame, si dhe duke bërë ndërlidhjen e shkaqeve doktrinare të ekstremizmit në të kuptuarit e dispozitave fetare, me realitetin e muslimanëve, dhe në veçanti me gjendjen faktike të administrimit të institucioneve fetare, si ato përfaqësuese, po ashtu edhe ato arsimore.

Evitimi i ekstremizmit në fushën e dispozitave islame, është çështje serioze dhe mjaftë komplekse, në veçanti, në kohën kur qasja te informacioni është shumë e lehtë, si dhe njohja e mendimeve të ndryshme, bile kontradiktore për një çështje, edhe atë duke u thirrur të dyja palët në argumente të fesë, arrihet shumë lehtë. Për këtë arsye, si rezultat i informatave të shumta dhe lehtë të arritshme, por shpesh herë kontradiktore

dhe që pretendojnë se mbështeten në burimet islame, me të drejtë është që njeriu të pyesë: Kë ta dëgojmë dhe si të vep-rojmë?

Duke marrë parasysh rëndësinë e temës në fjalë dhe në veçanti rëndësinë e dimensionit fetar, punimi i parë i këtij teksti i titulluar **“Ekstremizmi në fe, shkaqet dhe evitimi - një qas-je nga këndvështrimi Islam”**, i cili njëherësh përbën edhe ka-pitullin e parë të tij, i qaset kësaj çështjeje duke u përqendruar në definimin e tij, përcaktimin e kontekstit të shqyrtimit të tij brenda Islamit, shkaqet të cilat çojnë në ekstremizëm në fe, gjegjësisht në të kuptuarit e teksteve fetare si dhe në mënyrën e absorbimit të mësimëve fetare, *backgroundin* fetar të refuzi-mit të ekstremizmit, gjegjësisht disa argumente të burimeve ba-zë të Islamit, i cili si fe bazohet në refuzimin e ekstremizmit, si dhe në evitimin e ekstremizmit në fushën e dispozitave, gjegjë-sisht në të kuptuarit e dispozitave fetare, ku elaborohen disa as-pekthe dhe mënyra, që autori i punimit gjykon se janë më të rën-dësishme, edhe pse debati për këtë çështje do të vazhdojë të jetë i hapur dhe interesant.

Në kapitullin e dytë, **“Historiku i grupeve ekstremiste përgjatë historisë islame”**, shkoqitet përvoja e hidhur e rry-mave, e drejtimeve dhe e grupeve të ndryshme radikale dhe ekstremiste brenda trungut islam që janë paraqitur përgjatë historisë 14 shekullore të Islamit. Duke nisur me *havarixhët*, pastaj me *mu'tezilet*, e duke vazhduar me *vehhabinjët*, dhe kohë-ve të fundit me *talibanët*, el-Kaidën dhe IS-in, shihet edhe një herë qartë se ekstremizmi fetar është real, i prekshëm, dhe pa-raqitet në rrethana të caktuara dhe si pasojë e faktorëve të ndryshëm fetarë e jofetarë. Të gjitha këto grupime, edhe pse për herë të vogla dhe pakicë, por shumë të zhurmshme, kanë disa karakteristika të përbashkëta. Si rrjedhojë e krejt kësaj, pastaj, del në pah pak a shumë edhe profili i një individi fetar radikal e ekstremist, temë e cila do të trajtohet kah fundi i kapitullit të dytë.

Në kapitullin e tretë e trajtojmë çështjen e **“Radikalizimit të të rinjve muslimanë në Perëndim – shkaqet, proceset dhe sfidat”** kryesore të kësaj dukurie. Duke qenë se numri i të rinjve muslimanë që iu bashkëngjitën radhëve të organizatave tanimë të njohura terroriste me sfond islam u rrit dukshëm në vitet e fundit, ishte më se e nevojshme hulumtimi serioz dhe objektiv i shkaqeve dhe arsyeve se përse këta të rinj radikalizohen dhe marrin qëndrime ekstremiste, si zhvillohet procesi i radikalizimit, pra në çfarë forme ata e kalojnë këtë proces dhe së fundi cilat janë sfidat e gjithëmbarshme shoqërore kundrejt këtij fenomeni.

Librin që e keni në dorë është rezultat i suksesit të arritur në tri seminarët që janë mbajtur me të rinjtë tanë nëpër xhamitë shqiptare këtu në Zvicër nën patronatin e Unionit të Imamëve Shqiptarë në Zvicër (UISHZ) dhe si rezultat i angazhimit të gjithëmbarshtëm të imamëve dhe xhamive shqiptare në drejtim të parandalimit të këtij fenomeni të rrezikshëm.

Autorët  
Wetzikon, Kreuzlingen - Zvicër  
tetor 2018